



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2021:170419

Datë: 10.02.2025

Numri i dokumentit: 06828435

C.nr.743/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin individual Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gentiana Dakaj, në çështjen juridiko-civile të paditëses A.S. nga fsh. T.K. L., të cilën e përfaqëson Egzona Gashi av. nga Lipjani, me autorizimit, ndaj të paditurës Komunes së Lipjanit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson Behar Krasniqi av. publike, me autorizim, për shkak të kompenzimit të t'ardhurave personale, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur me dt.22.01.2025, në praninë e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, merr këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesëpadia e precizuar e paditësit paditëses A. S. nga fsh. T. K.L., si e **BAZUAR**, si dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Lipjanit - Drejtorati i Arsimit në Lipjan, që paditëses t'ia paguajë dhe atë në emër të shpenzimeve të Udhëtimit 70% të biletës për periudhën dt.02.08.2018-21.11.2022 për 768 ditë pune, në relacionin T.-L. dhe anasjelltas t'ia paguaj shumën prej 537.60-€, në emër të kompenzimit të kualifikimit për 27% të pagës bazë prej dt.21.01.2021-05.02.2023, shumën prej 1,251.84-€, në emër të shpërblimit Jubilar të përvojës së punës 50% të pagës bazë shumën prej 195.17-€, si dhe në emër të Kontributeve Pensionale në shumë prej 153.54-€, të gjitha këto shuma në emër të borxhit kryesor me kamat ligjore prej 8% nga dita e merrjes së aktgjykimit dt.22.01.2025, e deri në pagesën definitive, t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 608.40-€, e të gjitha këto në afat prej 7 dite nga dita e dorëzimit të aktgjykimit, nën kërcënimin të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësja A. S. nga fsh. T. K.L., në këtë gjykatë përmes të autorizuarës së tij, ka ushtruar padi ndaj të paditurës Komunes së Lipjanit, për shkak të kompenzimit të të ardhurave personale.

Në padi ka theksuar se paditësja është e punësuar tek e paditura në SHFMU "V. F." në Lipjan, Komuna Lipjan-DKA -DKA në bazë të kontratës së punës për kohë të pacaktuar dhe realizon pagesën mujore sipas të dhënave në listën e pagave të lëshuar nga BRK. Në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 të nënshkruar në mes të MASHT-it dhe SBASHK-ut, respektivisht neni 7 par. 1.3. e obligon të paditurën që paditëses të ia kompensoj shtesën në pagë në emër të kualifikimit dhe atë në 27% të pagës bazë, ngase pala paditëse është e kualifikuar me Bachelor dhe posedon licencën e mësimdhënësit/Karrierës bazuar në UA 05/2017. Po ashtu, ka përvojë pune sipas kushteve të parapara me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovës, për çka i takon shpërblimi jubilar për 11 vite të përvojës së punës dhe i takon e drejta për kompensim për ushqim gjatë punës (shujtave) në bazë të nenit 35 par. 7 dhe

par. 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit dhe SBASHK dhe atë nga 2 euro për ditët e pranisë në punë, e duke llogaritur nga data 18.04.2017 e deri në nxjerrjen e vendimit, sipas vërtetimit për ditët e punës. Në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe dt.21.01.2021 të nënshkruar në mes të MASHT-it dhe SBASHK-ut neni 35.5 e obligon të paditurën që paditëses të kompensoj shpenzimet e rrugës në lartësi prej 70% të biletës së trafikut urban për ata punëtor të arsimit që udhëtojnë nga vendbanimet e komunës përkatëse, e në këtë rast paditësja çdo ditë pune ka udhëtuar me destinacion T. – L. dhe anasjelltas për periudhën 18.04.2017 e gjerë sa të jetë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit, të cilat shpenzime do të llogariten në shqyrtim kryesor. Pala paditëse pretendon se paga jubilarë, shpenzimet të udhëtimit, ushqimit dhe pagesa shtesë në emër të kualifikimit nga ana e punëdhënësit tani e paditura, nuk është ekzekutuar në tërësi në raport me pagën bazë bazuar në listat e pagave për periudhën duke filluar nga data 18.04.2017 e tutje. Pasi që e paditura deri në ditën e ushtrimit të kësaj padie nuk ka realizuar detyrimet nga marrëdhënia e punës në tërësi, pala paditëse përmes të autorizuarve i propozon kësaj gjykate që në bazë nenit 90. par. 5 të Ligjit të punës dhe nenit 7 e 35 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë dhe pas administrimit të provave të aprovoj kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar.

Me parashtrësën e dt.22.01.2025 pala paditëse e ka bërë precizimin e lartësisë së kërkesëpadisë më konkretisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në fjalën përfundimtare e autorizuar e paditëses ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe deklarimeve. Gjykatës i ka propozuar që në tërësi ta aprovon precizimin e kërkesëpadisë për realizimin e kërkesës për shpërblim jubilar, shpenzimet e udhëtimit bazuar në nenin 35 par.5 dhe 8 të KKAK-së si dhe diferencën shtesë në emër të kualifikimit bazuar në vendimin e Qeverisë 01/33 të dt.29.08.2008, pasi kjo është vërtetuar nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe baza juridike ashtu edhe lartësia e kërkesëpadisë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka spacificuar sipas TOA-së.

Në të përgjigjur në padi si dhe në shqyrtimet gjyqësore e paditura e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e palës paditëse me arsyetimin se çështjet e kërkuara në padi janë pa bazë ligjore dhe se paditësit janë të punësuar tek e paditura dhe askund në kontratën e punës nuk ceket se punëtori i gëzon këto të drejta dhe paditësja i ka nënshkruar këto kontrata dhe është pajtuar me kushtet e kontratës si dhe detyrimet që i përmban. Poashtu as me Ligjin e Punës i cili rregullon kontestet e punës nuk ceket askund se punëtorëve iu takon kompensime të tilla, andaj kërkesës së paditësit i mungon baza juridike.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i të paditurës ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë të gjitha kundërshtimeve duke i propozuar gjykatës që ta refuzon kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar duke u mbështetur në nenin 46 par.2 të KKA si dhe faktin që vendimi i Qeverisë 01/33 nuk paraqet obligim për Komunën.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Për vërtetimin e gjendjes faktike në këtë çështje kontestimore gjykata në procedurën e provave ka bërë administrimin e provave dhe atë me shiqimin dhe leximin e Kontratës së Punës me nr.04-112-813/3041 dt.01.09.2020, të lidhur në mes paditësit dhe të paditurës së bashku me listen e pagës, me shiqimin dhe leximin e Diplomës bachelor të dt.10.12.2020, me shiqimin dhe leximin e licencës së mësimdhënësit me nr.1029580, me shiqimin dhe leximin e vërtetimit nr.85/21 i dt.03.06.2021 i SHFMU-V.F., me shiqimin dhe leximin e vërtetimit nr.553/24 i dt.09.10.2024 i SHFMU-V.F., me shiqimin dhe leximin e certificates së vendbanimit të dt.03.04.2018, dhe vërtetimi i dt.28.10.2024 të lëshuar nga shpk Lipjani, me shiqimin dhe leximin e ekspertizës financiare të ekspertit Behar Salihu e dt.13.12.2024, e të cilat prova gjykata i administroj dhe i vlerësoj në pajtim me nenin 8 të LPK-së, ku vërtetoi këtë gjendje faktike:

a).Paditësja **A. S.** ka themeluar marrëdhënie pune tek e paditura në SHFMU "V. F." në Lipjan si mësimdhënëse që ka punuar me përvojë pune mbi 11 vite.

b) Ndërsa për periudhën kontestuse e njëjta ka punuar 768 ditë pune dhe ka udhëtuar në relacionin T.-L. dhe anasjelltas ku i takon kompensimi për 70% të biletës së udhëtimit.

c) Për periudhën kontestuese paditësja ka punuar me Diplomë Universitare Bachelor ku i takon diferenca në emër të kualifikimit shtesa në pagën bazë për 27%.

Faktet nën a) gjykata e vërtetoi nga kontrata e punës e me nr.04-112-813/3041 të dt.01.09.2020, e lidhur në mes paditëses A. S. dhe të paditurës, si dhe nga Vërtetimi mbi përvojën e punës me nr.85/2021 i dt.03.06.2021, faktet nën b) gjykata i vërtetoi faktet nga Vërtetimi mbi ditët e pranisë në punë nr.553/24 i dt.09.10.2024, Vërtetimi nga kompania transportuse L. sh.p.k i dt.28.10.2024, Certifikata e vendbanimit e dt.03.04.2018, nr.E22363093, nga lista e pagës për periudhën kontestuse si dhe nga ekspertiza financiare e ekspertit Behar Salihu e dt.13.12.2024.

Me paragrafin 5 të nenit 35 të Kontratës Kolektive parashifet se “Punonjësve arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunes përkatëse ku punojnë, iu takon kompensimi prej 70 % të biletës së trafikut urban”.

Në bazë të nenit 35 par. 8 të Kontratës kolektive të Arsimit Parauniversitar të dates 18.04.2017, parashihet se *“Punëtorët (antarët e SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënsi i fundit dhe atë prej 50 % të një page bazë për 10 vjet të përvojës së punës”, 75 % të një page bazë për 20 vjet të përvojës së punës”, 100 % të një page bazë për 30 vjet të përvojës së punës”, 150 % të një page bazë për 40 vjet të përvojës së punës”.*

Me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/33 të dt.29.08.2008 parashifet se nga 1 Shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësve etj do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendës drejtorëve dhe bashkëpunorëve profesional, me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me një ngritje të pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35 %.

Me dispozitat e nenit 8 të LMD-së, të R. së Kosovës, parashihet se *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”.* Ndërsa me dispozitën e nenit 245 po të njëjtit Ligj parashihet se *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi në përputhje me përmbajtjen e tij”.*

Pra, bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike dhe dispozitat e lartcekura gjykata vjen në përfundim se e paditura përkundër kërkesës së bërë nga paditësi nuk ia ka paguar këto të drejta që i takojnë sipas kontratave të lartë përmendura nga këto arsye gjykata e detyroi të paditurën që paditëses **A. S.** në emër të shpenzimeve të udhëtimit për periudhën dt.02.08.2018-21.11.2022 për 768 ditë pune t’ia paguaj shumën prej 537.60.00-€, në emër të Kualifikimit diferencës shtesë në pagë në lartësi prej 27% të pagës bazë për periudhën prej dt.21.01.2021-05.02.2023 t’ia paguaj shumën prej 1,251.84-€, si dhënë emër të Shpërblimit jubilar për 50% të pagës bazë t’ia paguaj shumën prej 195.17-€, më konkretisht siç është vendosur në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes gjykata vlerësoj kundërshtimet e të paditurës të theksuara në përgjigje në padi dhe seancën përgatitore, mirëpo të njëjtat kundërshtime i refuzoj si të pabazuara me arsyetimin se në nenin 46 të Kontratës Kolektive të Arsimit e dt.18.04.2017 dhe nenit 45 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.22.01.2021 është paraparë që MASHT-i dhe SBASHK-u angazhohen për t’i informuar Komunitat që me kohë të bëjnë planifikimin e buxhetit për zbatimin e këtyre të drejtave dhe po ashtu të angazhohen në Ministrinë e Financave për sigurimin dhe ndarjen e mjeteve financiare për Komunitat me qëllim të realizimit të buxhetit të nevojshme për përmbushjen e këtyre detyrimeve. Sa i përket kualifikimit, pra shtesës të pagës bazë për kualifikim gjykata i pati parasysh qëndrimet e gjykatave më të larta ku kanë dhënë mendime se kjo e drejtë nuk i’u takon në bazë të nenit 7 të KKAK-së, sepse kjo dispozitë nuk ka

karakter imperativ, mirëpo gjykata këtë të drejtë e gjykoj siç u tha më lartë në bazë të Vendimit të Qeverisë nr.01/33 e dt.29.08.2008 për rritje i cili vendim ka qenë në fuqi deri në ligjin për pagat dhe mbi bazën e këtij vendimi janë përcaktuar pagat dhe mbi këtë bazë ende mësimdhënësit i marrin pagat nga punëdhënësi mirëpo shtesa në emër të kualifikimit është paguar deri në nxjerrjen e ligjit për paga por me një shtesë të llogaritur më parë ku paga bazë ka qenë më e ulët dhe me rritjen e pagës bazë nuk është rritur shtesa në kualifikim andaj eksperti financiar e ka bërë llogaritjen vetëm të diferencës të shtesës në kualifikim.

Vendimi për kumatën ligjore u bazua në nenin 382 të LMD-së.

Meqenëse pala paditëse e ka fituar kontestin dhe i ka kërkuar shpenzimet, gjykata në pajtim me nenin 452 dhe 453 të LPK-së, e detyrojë të paditurën që paditësve t'ia kompenzoj shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë: për përpilimin e padisë në shumë prej 104.00-€, për përpilimin e precizimit të kërkesëpadisë shumë prej 104.00.-€, për 2 (dy) seancë gjyqësore të përfaqësuar nga e autorizuar e palës paditëse shumë nga 135.20-€, për ekspertizë financiare në shumë prej 100-€ si dhe në emër të taksës për padi në shumë prej 30.-€ apo shumë e përgjithshme prej 608.40-€, shpenzime këto që kanë qenë të nevojshme për përfundimin e këtij kontesti për çka është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë dhe në bazë të dispozitave të lartcekura si dhe nenit 136 të LMD-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA LIPJAN
C.nr.743/21 me dt.22.01.2025

GJYQTARI,
Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së të njejtit, përmes kësaj gjykate.